

URDHËR
Nr. 678, datë 17.11.2023

**PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 627, DATË 15.12.2021, “PËR DELEGIMIN
E DISA RREGULLAVE TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 16, të ligjit nr. 90, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 627, datë 15.12.2021, bëhet shtesa si vijon:

1. Pas pikës 5, shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Nënshkrimi i kërkesave për heqje dorë nga ankimi bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili mund ta delegojë këtë të drejtë tek përfaqësuesi i caktuar për çështje konkrete. Sekretari i Përgjithshëm ndjek dhe konfirmon kërkesat e paraqitura për çështje në gjykim”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj